

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E REGJISTRIT ELEKTRONIK TË KONCESIONEVE DHE PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi ka për qëllim krijimin e një regjistri elektronik kombëtar, të unifikuar dhe të standardizuar, në të cilin do të regjistrohen, administrohen dhe publikohen të dhënat që lidhen me kontratat e koncesioneve dhe partneriteteve publik-private, përgjatë gjithë ciklit të jetës së tyre, duke filluar nga lidhja e kontratës deri në përfundimin e saj. në zbatim të 3 të nenit 17 të ligjit nr. 88/2025 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” dhe nenin 4 të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

Projektvendimi synon të risë transparencën dhe llogaridhënien në administrimin e kontratave të koncesioneve/PPP, të mundësojë monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të kontratave, të krijojë një bazë të unifikuar të të dhënave për të gjitha institucionet publike, të lehtësojë analizën, raportimin dhe mbikëqyrjen institucionale si dhe të garantojë aksesin e publikut në informacion, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi i mësipërm nuk është parashikuar në programin analitik të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, por është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me miratimin e ligjit nr. 88/2025 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, është parashikuar një qasje të re në administrimin dhe monitorimin e kontratave të koncesioneve dhe partneriteteve publik-private, duke parashikuar krijimin e një regjistri elektronik të posaçëm.

Aktualisht, informacioni mbi kontratat e koncesioneve dhe PPP-ve administrohet në mënyrë të fragmentuar nga autoritetet kontraktuese, pa ekzistuar një sistem unik kombëtar që të sigurojë standardizimin e informacionit, përditësimin periodik të të dhënave, monitorimin në

kohë reale të kontratave, raportimin e unifikuar për institucionet përgjegjëse si dhe transparencën ndaj publikut.

Kjo situatë krijon vështirësi në monitorimin institucional të kontratave, në analizimin e angazhimeve financiare të shtetit, në evidentimin e ndryshimeve kontraktore, si dhe në përgatitjen e raporteve për organet mbikëqyrëse dhe auditimin.

Në këtë kontekst, është e nevojshme krijimi i një regjistri elektronik të centralizuar, i cili do të shërbejë si baza zyrtare e të dhënave për të gjitha kontratat e koncesioneve dhe partneriteteve publik-private.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në:

- nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- pikën 3 të nenit 17 të Ligjit nr. 88/2025 "Për koncesionet dhe partneritetet publik-private";
- Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore";
- Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar;

Projektvendimi është në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe nuk bie në kundërshtim me dispozitat kushtetuese apo me legjislacionin material e procedural në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektvendimi është në përputhje me parimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e koncesioneve dhe partneriteteve publike private. Projektakti nuk bie në kundërshtim me acquis të Bashkimit Evropian dhe kontribuon në përafrimin e mëtejshëm të kuadrit institucional shqiptar me praktikat evropiane.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përbëhet nga 16 pika dhe një aneks, ku në mënyrë të përmbledhur parashikohet parashikon:

- ngritjen dhe administrimin e Regjistrit Elektronik të Koncesioneve/Partneriteteve Publike-Private;

- administrimin e regjistrit nga Institucioni Përgjegjës për Koncesionet dhe Partneritetet Publike-Private;
- përcaktimin e kategorive të të dhënave që regjistrohen në sistem;
- bashkëveprimin e regjistrit me bazën e të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit;
- përcaktimin e autoriteteve dhe entiteteve kontraktuese si ofrues të informacionit;
- rregullimin e mënyrës së publikimit të informacionit në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- detyrimin e autoriteteve kontraktuese për dorëzimin e dokumentacionit dhe ndryshimeve kontraktore brenda afateve të përcaktuara;
- krijimin e profileve të përdoruesve dhe administrimin e aksesit sipas roleve;
- gjenerimin e raporteve periodike nga sistemi;
- mbulimin e shpenzimeve të krijimit dhe mirëmbajtjes së regjistrit nga buxheti i institucionit përgjegjës.

1. Krijimin e Regjistrit Elektronik të Koncesioneve/PPP-ve

Vendimi krijon Regjistrin Elektronik të Koncesioneve/Partneriteteve Publik-Private (REKP), i cili do të administrohet nga institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetet publik-private dhe do të publikohet në faqen zyrtare të këtij institucioni.

2. Administrimin e regjistrit

Përcaktohet institucioni përgjegjës për administrimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit elektronik.

3. Përmbajtjen e regjistrit

Regjistri do të përmbajë, ndër të tjera, të dhënat e autoriteteve kontraktuese, objektin dhe llojin e kontratës, kohëzgjatjen, vlerën e investimit, vlerën e kontratës, tarifat dhe pagesat, tekstin e plotë të kontratës, studimin e fizibilitetit, dokumentacionin e procedurës, ndryshimet kontraktore, transferimet, marrëveshjet e nënkontraktimit, dokumentacionin mbi pronësinë, dokumentet mbi përfundimin e kontratës. Gjithashtu sistemi do të ndërveproj me regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit për marrjen automatike të të dhënave mbi operatorët ekonomikë.

4. Ofruesit e informacionit

Projektvendimi përcakton detyrimet e autoriteteve kontraktuese dhe subjekteve kontraktuese për dorëzimin e informacionit dhe dokumentacionit.

5. Publikimi i të dhënave

Regjistri do të jetë publik dhe pa pagesë, duke respektuar kufizimet e parashikuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit.

6. Detyrimet e autoriteteve kontraktuese

Autoritetet kontraktuese do të kenë detyrimin të dorëzojnë dokumentacionin e kontratës, të raportojnë ndryshimet kontraktore, të përditësojnë informacionin, të raportojnë progresin e zbatimit si dhe të evidentojnë problematikat gjatë zbatimit.

7. Raportimi

Sistemi do të gjenerojë raporte mbi ecurinë e kontratave, realizimin financiar, performancën e kontratave, ku raportet do të mund t'u vihen në dispozicion Ministrisë përgjegjëse për financat dhe institucioneve mbikëqyrëse.

8. Siguria e sistemit

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ngarkohet me garantimin e sigurisë së sistemit elektronik dhe mbrojtjen e të dhënave.

9. Menaxhimi i përdoruesve

Projektvendimi përcakton akses të diferencuar sipas roleve të përdoruesve dhe administrimin e kredencialeve individuale.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen autoritetet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi dhe monitorimi do të kryhet nga strukturat përgjegjëse për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit. Në kuadër të procesit të bashkërendimit institucional, projektvendimi u është përcjellë për mendim institucioneve përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk sjell nevojë për fonde shtesë nga buxheti i shtetit përtej fondeve të miratuara për funksionimin e institucionit për vitin 2026. Për vitin 2027 Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka bërë kërkesë për fonde shtesë pranë Ministrisë së Financave, pasi në zbatim të 3 të nenit 17 të ligjit nr. 88/2025 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat diktohet nevoja e krijimit të një regjistri elektronik kombëtar, të unifikuar dhe të standardizuar, në të cilin do të regjistrohen, administrohen dhe publikohen të dhënat që lidhen me kontratat e koncesioneve dhe partneriteteve publik private, përgjatë gjithë ciklit të jetës së tyre, duke filluar nga lidhja e kontratës deri në përfundimin e saj.

MINISTRI

DELINA IBRAHIMAJ

